

VENDIM
Nr.598, datë 10.9.2004

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.579, DATË 8.12.1999 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KUSHTET DHE MASËN E PËRFITIMEVE NGA SIGURIMI
SHOQËROR SUPLEMENTAR TË USHTARAKËVE DHE ANËTARËVE TË FAMILJEVE
TË TYRE, NË RASTET E NXJERRJES SË TYRE NË REZERVË, LIRIM APO PENSION”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 21 të ligjit nr.8087, datë 13.3.1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Kombëtar”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 1/1 të shkronjës “B” të kreut II të vendimit nr.579, datë 8.12.1999 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, pas shprehjes “...shtesa për punë të vështirë e të dëmshme për shëndetin.”, të shtohet “...shtesë për ruajtje page.”.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes, miratuar për vitin 2004.

3. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes dhe Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.1.2004.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano